

## MIÇO SAMARA

## MBI LEKSIKUN POLITIKO-SHOQËROR TË SHQIPES DHE ZHVILLIMIN E TIJ PAS ÇLIRIMIT

Gjuha, dhe veçanërisht leksiku, janë të lidhur drejtpërdrejt me veprimtarinë prodhuese të njeriut në të gjitha sferat e jetës së tij. Çdo ndryshim në jetën politike, ekonomike, shoqërore e kulturore të një populli pasqyrohet shpejt në gjuhë nëpërmjet leksikut. Leksiku ka veçorinë të gjendet më shumë se çdo anë tjetër e gjuhës, gjithnjë në zhvillim, në ndryshim e sipër<sup>1</sup>.

Ndryshime të mëdha kanë ndodhur në leksikun e shqipes gjatë këtyre 25 vjetve të çlirimit. Këto ndryshime vihen re si në leksikun e përgjithshëm ashtu edhe në atë terminologjik; ato janë mjaft të theksuara në fushën e leksikut politiko-shoqëror.

Zhvillimi i leksikut politiko-shoqëror pas çlirimit, në vija të përgjithshme, ka shkuar në po atë rrugë që ka shkuar zhvillimi i të gjithë leksikut në përgjithësi. Megjithatë zhvillimi i leksikut politiko-shoqëror pas çlirimit ka edhe veçoritë e veta, pak a shumë të ndryshme nga ato të leksikut të fushave të tjera. Studime të veçanta gjuhësore mbi këtë leksik deri më sot mungojnë. Nuk kemi akoma të botuar një fjalor të terminologjisë politiko-shoqërore. Megjithëse, në disa tekste shkollore e artikuj të ndryshëm leksikologjikë e leksikografikë<sup>2</sup> janë prekur çështje që kanë të bëjnë me pasurimin në këto vjetët e fundit të leksikut politiko-shoqëror, të pasqyrimin të tij ndër fjalorë etj., nuk është sqaruar mirë bile as çështje ky leksik dhe vendi që ai zë në leksikun e përgjithshëm të shqipes.

Në këtë punim do të përpiqemi të japim disa tipare të leksikut të sotëm politiko-shoqëror të shqipes dhe disa veçori të zhvillimit të tij në etapën e sotme duke u mbështetur në ndryshimet që ka pësuar ky leksik pas çlirimit.

I. Leksiku i sotëm politiko-shoqëror i shqipes ngërthen fjalë e togfjalëshe që shënojnë koncepte themelore nga sfera e jetës politike e shoqërore. Ato janë kryesisht:

a) fjalë e togfjalëshe që lidhen me PPSH dhe jetën e saj organizative, me lëvizjen komuniste botërore, marksizëm-leninizmin, përkrahësit e kësaj ideologjie etj. p.sh. *aktiv-i, internacionalizëm, inter-*

1) Shih J.V. Stalin, *Mbi çështjen e marksizmit në gjuhësi*, Tiranë 1951, f. 10.

2) Shih J. Stefi, *Leksikologjia shqipe*, Tiranë 1961; A. Kostallari, *Në rrugën e hartimit të fjalorit normativ të shqipes së sotme*, në «Buletin për shkencat shoqërore», nr. 4, 1955; *Parimet themelore për hartimin e «Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe»*, në «Studime filologjike», nr. 2, 1968.

*nacionalist, kongres, komunist-i, komunist-e, leninist, marksizëm, marksist-i, marksist-e, parti, plenum, sekretar-i, sekretare-ja, anëtar partie, kandidat partie, byro politike, organizatë bazë* etj.

b) fjalë e togfjalëshe që emërtojnë organizata të ndryshme të masave dhe elemente të strukturës së tyre organizative, institucione shtetërore të partisë e të pushtetit si *rini, bashkimet profesionale, fronti demokratik, kuvendi popullor, komiteti qendror, këshilli i ministrave (kryeministri-a), komiteti ekzekutiv* etj.

c) fjalë e togfjalëshe që kanë të bëjnë me sistemet e kaluara shoqërore, klasat e luftën e klasave, luftën kundër ideologjisë së huaj dhe mbeturinave të saj në ndërgjegjen e njerëzve tanë si *bujkrob, bajraktarizëm, demonstratë, feudalizëm, fshatarësi, grevë, inteligjencë, imperializëm, klasë, kulak, luftënxitës, nënështrim, paqëndashës, revizionizëm, revizionist-i, revizionist-e, skllavopronari-a, skllavopronar-i, shfrytëzim, i shtypur, shovinizëm, social-imperializëm, klasë punëto-re, luftë e klasës, mbeturina mikroborgjeze, ndërgjegje klasore* etj.

ç) fjalë e togfjalëshe që lidhen me luftën revolucionare të punonjësve tanë nën udhëheqjen e partisë, me fenomenet e reja ose me marrëdhënjet e reja ndërmjet njerëzve në shoqërinë tonë socialiste etj. p.sh.: *auto'kritikë, aksion, aksionist-i, aksioniste-ja, fletërrufe, kritikë, kolektiv-e, kolektiv-i, kolektivizoj, kolektivizim, kooperativë-a, kooperativizëm, kooperativist-e, manifestim, partishmëri, proletar-e, revolucionar-e, revolucionar-i, revolucionarizoj, revolucionarizim, revolucionarizues, vëllazëror, vullnetar-e, vullnetar-i, shok-u, shoqe-ja, pushtet popullor, reformë agrare, ndërgjegje socialiste* etj.

Leksiku i sotëm politiko-shoqëror i shqipes përfshin edhe fjalë e togfjalëshe nga sfera e filozofisë<sup>3</sup>, diplomacisë, drejtësisë, ekonomisë politike etj., të cilat shënojnë sende, fenomene a koncepte që sot kanë marrë karakter të theksuar politiko-shoqëror p.sh. *bazë, dialektik-e, kontradiktë, ndërgjegjë, objektiv-e, primar-e, subjektiv-e, superstrukturë, thelb, materializëm dialektik, ambasador, diplomat, diplomatik, notë, akuzë, e drejtë-a, krim, ligj, ligjor, mbivlerë, krizë, kapital* etj. Këta terma kanë dalë tashmë nga sfera e tyre e ngushtë tepër speciale dhe kanë hyrë ose po hyjnë në përdorim të përgjithshëm në shtyp, tekste shkollore, fjalime etj.

Nga ana tjetër, si terma politiko-shoqërore përdoren sot shumë fjalë nga leksiku i përgjithshëm si p.sh. *brumos, i brumosur* (me ideologjinë marksiste-leniniste), *frymë-a* (revolucionare), *gjakpirës, kthesë* (revolucionare), *kukëll* (qeveri), *nënështroj, nënështrim, i nënshtruar, sundoj, sundim, shtyp, shtypje-a, i shtypur* (popull), *shfrytëz* (një klasë shoqërore), *shfrytëzim, i shfrytëzuar, zgjedhë* (politike) etj. Këta janë terma jo të mirëfilltë që në semantikën e tyre kanë edhe kup-time të tjera. *Kuptimi terminologjik* i këtyre fjalëve, për arsye të përdorimit të gjërë në këtë fushë të terminologjisë, është veçuar qartë nga *kuptimet* e tjera *jotermnologjike*.

Disa nga termat e leksikut politiko-shoqëror u përkasin edhe fushave të tjera të terminologjisë p.sh. *aparati* (i K.Q.) dhe në terminologjinë tekniko-shkencore të mekanikës, *instrument* (ratifikimi) dhe në

3) Sigurisht jo të gjitha fjalë-termat e filozofisë bëjnë pjesë në leksikon politiko-shoqëror; nuk futen këtu fjalë-termat tepër speciale për këtë fushë si *agnosticizëm-i, antinom-i, deizëm-i, mahizëm-i, njëkohësi-a, shkakësi-a, e vërteta absolute e relative* etj. E njëjta gjë duhet thënë edhe për leksikon politiko-shoqëror nga sfera e diplomacisë, drejtësisë, ekonomisë politike etj.

teknikë ose në muzikë, *rrymë* (= drejtim politik, filozofik etj.) dhe në elektricitet etj.

Përgjithësisht tipari themelor i termave të leksikut politiko-shoqëror është se ata kanë vetëm një *kuptim terminologjik* dhe shënojnë koncepte të veçanta d.m.th. një fjalë një koncept. Termat jo të mirëfillta, që kanë më tepër se një kuptim (*brumos, sundim, shfrytëzim*) nuk përbëjnë boshtin e terminologjisë politiko-shoqërore; ata qëndrojnë në anë të kësaj terminologjie dhe për veçoritë semantike që kanë i afrohen shumë leksikut të zakonshëm.

II. Në krahasim me paraqitimin leksiku politiko-shoqëror i shqipës ka ndryshuar dhe është zhvilluar si nga ana sasiore ashtu edhe nga ana cilësore. Këto ndryshime vihen re në plan semantik dhe fjalëformues.

a) Një nga ndryshimet në *plan semantik* që vihet re në këta terma është lindja e *kuptimit* të ri *terminologjik* që kanë marrë fjalët e leksikut të përgjithshëm, zakonisht si rezultat i zgjerimit a ngushtimit të kuptimit të tyre. Në këtë mënyrë janë ngritur në term fjalët të tilla me përhapje e përdorim të gjerë popullor si *bazë* në filozofi («Koncepti mbi bazën dhe superstrukturën e shoqërisë» BFM, f. 370) dhe në kuptimin *ç'ka është periferike në lidhje me qendrën dhe ka të bëjë drejtpërsëdrejti me masat*<sup>4</sup> («Kemi të bëjmë me një aksion të madh që kërkon punë intensive që nga organet drejtuese në qendër e deri në bazë» ZP, 1.9.66, f. 2), *hop* (BFM, f. 208), *hapësirë* (BFM, f. 116), *thelb* (BFM, f. 260), *shtresë* (shoqërore), *udhëheqje* (= tërësia e udhëheqësve të partisë e të shtetit të një vendi. «Veprimet agresive të udhëheqjes sovjetike ndjekin njera-tjetrën» Bashk., 27.9.69, f. 3), *kohë* (BFM, f. 116), *lëvizje* (BFM, f. 108) etj. Gjithashtu kanë filluar të përdoren me *kuptim* të ri *terminologjik* fjalët e leksikut të përgjithshëm: *motër* (parti), *vëlla* (popull), *i nderë* («Atë që duan dy fuqitë e mëdha është... likuidimi i problemit palestinez dhe ruajtja e gjendjes së nderë». Bashk. 27.9.69, f. 3), *poshtë* («Ashtu siç na pososit shoku Enver në të ardhmen do të forcojmë më tepër kontrollin e kritikën nga poshtë» ZP, 7.5.68, f. 2), *pazarllëqe* (politike), *i huaj* (= që s'pajtohet me ideologjinë tonë. «I madh e i vogël është ngritur në këmbë për të djegur me zjarr koncepte e çfaqje të huaja». ZP, 17.3.68, f. 2), *zë-ri* (fjalë, opinion)<sup>4</sup> etj.

b) Një tjetër ndryshim në semantikën e këtyre termave është diferencimi kuptimor i bërë në vargun sinonimik të disa termave si *konferencë* e *mbledhje* («Organi udhëheqës më i lartë i çdo organizate të partisë është mbledhja e përgjithshme (për organizatat bazë), konferenca (për organizatat e partisë të rretheve dhe qyteteve) dhe kongresi (për të gjithë partinë)». Statuti i PPSH, 1961, f. 49), *udhëheqës-i* («Midis tyre ishte dhe udhëheqësi i partisë dhe i popullit shoku Enver Hoxha». ZP, 7.5.1968, f. 1) dhe *drejtuës-i* («Në sesionin shkencor... ndodheshin edhe drejtues të partisë e pushtetit dhe përfaqësues të organizatave të masave në rreth». Bashk. 19.10.1969, f. 1). Gjithashtu ka filluar të diferencohet akoma më qartë kuptimi i fjalëve *ndërgjegjë* dhe *vetëdijë*, të cilat për një kohë të gjatë janë përdorur, që të dyja, si terma në filozofi. Tashmë vetëm fjala *ndërgjegjë-a* përdoret si term në filozofi, kurse fjala *vetëdijë* përdoret në kuptimin e saj të *qënë*t në *dijeni* të *plotë* të *vetvetes* (p.sh. e bëj me vetëdijë)<sup>4</sup>.

4) Shih *Fjalorin e gjuhës shqipe*, 1954.

Nga dy sinonimet *kre-u* dhe *kokë-a*, vetëm i pari përdoret si term politik-shoqëror me një farë ngarkese stilistikore keqësuese («Krerët revizionistë janë gjithashtu të rrethuar nga kontradikta». ZP. 27.9.69, f. 3).

c) Si ndryshim në semantikën e termave politik-shoqërorë pas çlirimit mund të merret edhe rivlerësimi kuptimor i fjalëve të leksikut të vjetër politik-shoqëror si *borgjez*, *fashist*, *fashizëm*, *proletariat*, *punëtor*, *fshatar* a *katundar*, *shërbëtor* («Çdo anëtar i organizatës së gruas së NTLAP-it i ka vënë detyrë vehtes të meritojë titullin e lartë shërbëtor i popullit». Shqiptarja e re, nr. 10, 1966, f. 9. «Në këto kushte të qëndrosh në Traktatin e Varshavës do të thotë të bësh pjesë në një traktat agresiv, antisocialist, të jesh shërbëtor i klikës revizioniste të Kremlinit». ZP. 13.9.68, f. 1), *xhandar* («Imperializmi amerikan, si qen roje, për politikën hegjemoniste të xhandarit ndërkombëtar duhej të financonte me armë e kredi dhe qen roje të tjerë». ZP, 31.3.68, f. 4), *bej*, *aga*, *zonjushë*, *zotëri*, («A nuk është ky një qëndrim prej zotërie që tregon mungesë respekti, konsideratë ndaj zërit të masave ndaj mendimeve e propozimeve të tyre? ZP. 10.1.67 f. 3 etj.), *car-i* («Carët e rinj të Kremlinit kanë dërguar trupat e tyre në Çekosllovakia për ta mbajtur vendin nën sundimin e tyre». Bashk., 19.10.69, f. 4). Në këto raste, ka ndryshuar qëndrimi shoqëror ndaj sendit, fenomenit a konceptit që ata shënojnë; ky qëndrim varet nga ideologjia sunduese në shoqëri. Këtë veçori të leksikut politik-shoqëror nuk e ka leksiku i fushave të tjera të terminologjisë, të themi terminologjia tekniko-shkencore e mekanikës a e matematikës, ku klasat zakonisht nuk mbajnë qëndrime krejt të ndryshme ndaj sendeve a koncepteve të shënuara nga terma të asaj fushe. Vlerësimi kuptimor i leksikut politik-shoqëror që lind nga qëndrimi i ndryshëm i klasave ndaj sendeve e fenomeneve që ata shënojnë gjen shprehje edhe në pasqyrimin e tyre në fjalorin shpjegues. Nuk është aspak e rastit p.sh. që në fjalorin shpjegues të italishtes të F. Palac-it<sup>5</sup> fjala *revolucion* shpjegohet kështu: *ndryshim i një qeverie me dhunë, kryengritje, rebelim i popullit*. Sigurisht autori i këtij fjalori e ka bërë këtë i mbështetur në pozitat e ideologjisë borgjeze dhe për t'iu shërbyer interesave të asaj klase së cilës i përket. Kjo tregon se ndaj leksikut politik-shoqëror klasat nuk qëndrojnë indiferente.<sup>6</sup>

Në *plan fjalëformues* veçoria themelore e zhvillimit të leksikut politik-shoqëror pas çlirimit është prodhimtaria e madhe e termave të formuara sintetikisht duke shfrytëzuar më shumë mënyrën afiksale pastaj atë joafiksale dhe kompozimin.

Kështu sipas tipit të fjalëformimit parashtesor janë formuar terma a) me parashtesat antonimike mohuese *pa-*, *jo-*, *mos-* p.sh. *i paparti*, *i paorganizuar*, (aë nuk është anëtar i organizatës), *i papartishëm*, *pa-partishmëri-a* (BFM, f. 29), *jodialektik-e* (BFM, f. 246), *jorevolucionar-e*, *jo proletar-e*, *jobolshevik-e* (PPSH mbi centr. dem. f. 116), *mosnjohje-a* (BFM, f. 187), b) me parashtesat antonimike privative e kundërshtuese *ç-* a *sh-*, *anti-*, *kundër-* p.sh. *çburokratizoj*, *çmaterializoj*, *antipunëtor-e*, *antiimperialist-e*, *antirevizionizëm-i*, *kundërrevolucionar-i* etj. c) me parashtesa të tjera: *mbi-*, *para-* p.sh. *mbivlerë-a* (Len. XXI, f. 54), *mbipunë-a* (Kap. f. 292), *paramarksist-e*, *parashtetëror-e* etj.

Sipas tipit të fjalëformimit prapashtesor janë formuar terma me

5) F. Palazzi, *Novissimo dizionario della lingua italiana*, 1940, f. 1000.

6) Shih J.V. Stalin, *Mbi çështjen e marksizmit...* f. 11.

prapashtesat *-(ë)ri, -or, -isht, -izëm*<sup>7</sup>, etj. p.sh. *domosdoshmëri-a, pacënueshmëri-a, pathyeshmëri-a, programor-e* (EH. 1. f. VI), *rutinor-e* (Dr. 13.7.69 f. 2), *botëkuptimor-e* (ZP. 14.3.69, f. 3), *vleror-e* (Kap. f. 75), *klasor-e, i ligjshëm, komplotues-e, revolucionarisht* (H. PPSH, f. 83), *titizëm-i, zyrtarisht-i, rrymëzë-a, shkollëzë-a* (BFM, f. 73) etj.

Me mënyrën joafiksale janë formuar terma nëpërmjet substantivimit të mbiemrave si *qarkor-i* (P. agimit II f. 52), *i plotfuqishmi* (i lagjes), *i shfrytëzuar, dialektik-u, revolucionare-ja, konservatore-ja, objektive-ja* (BFM f. 78), *reale-ja* (BFM, f. 99), *marksist-leninist-i* etj.

Nëpërmjet kompozimit janë formuar *grevëthyes, luftënxitës, llogaridhënës* (ZP, 24.12.68, f. 2), *gruporganizatë, fletërrufe, kryerevizionist, bashkëluftëtar, bashkekzistencë, ideopolitik-e, ideopolitikisht, gjysëmproletar, gjysëmfeudal, politik-shoqëror, imperialisto-revizionist* etj.

Në leksikun e ri politik-shoqëror të shqipësisë një vend të rëndësishëm zënë njësitë e reja leksikore të formuara analitikisht (d.m.th. të togfjalësheve të qëndrueshme) brenda shqipësisë ose si një huazim jo i drejtpërdrejtë d.m.th. me anë të kalkimit: *gara socialiste, kryengritje e armatosur, luftë nacionalçlirimtare, rrugë parlamentare, vijë e masave, centralizëm demokratik, zonë (sferë) influence, thërres në raport, mbështetet në forcat e veta, puna në prodhim, tigër prej letre, luftë klasore, këshill popullor, tryezë e rrumbullaktë, tryezë e bisedimeve, bashkësi socialiste, sovranitet i kufizuar, sigurim kolektiv, këshilli i sigurimit, shtyp me zjarr dhe me hekur* etj.

Në fushën e formimit të fjalë-termave të rinj politik-shoqërore gjuha shqipe karakterizohet nga prirja për t'i plotësuar kryesisht me mjetet e veta leksikore-fjalëformuese kërkesat që i shtron zhvillimi i shoqërisë. Por leksiku ynë politik-shoqëror pas çlirimit është pasuruar mjaft edhe me terma të huazuar drejtpërdrejt nga gjuhët e huaja. Të tilla janë termat *forum, juntë, revanshist-i, revanshist-e, janki, ultra, deviacion, komsomol, narodnik, nep*, si edhe shumica e fjalëve me *-izëm* si *centrizëm, trockizëm, neokolonializëm, social-imperializëm, golizëm, konformizëm, social-shovinizëm, pacifizëm* etj. Zakonisht secilit prej këtyre emrave të fundit, të cilat shënojnë doktrina, rryma a drejtime të ndryshme politike-filozofike u korespondojnë emrat me *-ist*, gjithashtu të huazuara potnuaj në të njëjtën kohë, që tregojnë bartësit, ndjekësit e këtyre rrymave a drejtimeve politike (*centrist, trockist, neokolonialist, social-imperialist, golist, konformist, social-shovinist, pacifist*). Përgjithësisht këto janë terma ndërkombëtarë, që i gjejmë në disa gjuhë.

Karakteristikë e këtyre vjetve të fundit të çlirimit dhe prirje zotëruese për të ardhmen është se huazimet që hyjnë drejtpërdrejt në këtë fushë po ua lëshojnë vendin huazimeve jo të drejtpërdrejta d.m.th. kalkimeve. Le të krahasojmë për këtë rus. *partijnost', opastnost', njeizbjezhnost', njeobhadimost', njeprimirnost', narodnij vllast'*, fr. *coexistence pacifique, bilateral-e, lutte froide* (rus. *mirnoje sossushestvovanie, hollodnaja barba*), angl. *eskalejshën* (rus. *eskalacia*), fr. *neutralité*, (rus. *nejtralitet*) dhe shqip *partishmëri, rrezikshmëri, pashmangshmëri, domosdoshmëri, papajtueshmëri, pushtet popullor, bashkekzistencë paqësore, dypaleshe* (bisedime) a i *dyanshëm, luftë e ftohtë*,

7) Kjo prapashtesë është e huazuar dhe joprodhuse për shqipen shumica e fjalëve të leksikut politik-shoqëror me këtë prapashtesë kanë hyrë drejtpërdrejt nga gjuhët e tjera si ndërkombëtarizma.

*shkallëzim* (i luftës), *asnjanësi-a*, ku përputhjet strukturore midis shqipës dhe gjuhëve të tjera indoevropiane duken të drejtpërdrejta, por nuk ka thyerje të strukturës së shqipës për hir të ruajtjes së modelit të huaj fjalëformues<sup>8</sup>.

Si rezultat i shfrytëzimit të këtyre mjeteve fjalëformuese të shqipës pas çlirimit vihet re prirja për të nxjerrë jashtë përdorimit shumë terma politiko-shoqërorë që kanë hyrë pa nevojë në gjuhën tonë si *apel*, *angazhohem*, *angazhim*, *linjë* (e përgjithshme politike) *komunitet*, *neutralitet*, *superioritet*, *tendencë*, *tentativë*, *central-e*, *korrent* (politik), *diskriminacion* (racial), *situatë* etj., të cilat janë zëvendësuar ose po zëvendësohen me *thirrje*, *zotohem*, *zotim*, *vijë*, *bashkësi-a*, *asnjanësi-a* («Tani në shumë vende të pavarura të Azisë e Afrikës flitet për një politikë që quhet e «asnjanësisë pozitive». J. Malo... Bota arabe. f. 15), *epërsi*, *prirje*, *përppjekje*, *qendror-e*, *rrymë*, *dallim*, *gjendje* etj. Mbetet akoma si një detyrë e së ardhmes puna për zëvendësimin e disa termave politiko-shoqërorë të huazuar pa nevojë, i cili vazhdon të përdoret gjërësisht, ose puna për shqipërimin e ndonjë tjetri si *unanimisht*, *aprovoj*, *aprovim*, *restaurim*, (i kapitalizmit), *okupator*, *personal* (interes), *principialitet*, *primare*, *superprodhim*, *marr nën patronazh* etj. duke përdorur *njëzëri*, *miratoj*, *miratim*, *rivendosje* (e kapitalizmit), *pushtues*, *vetiak*, *parimorësi-a*, *parësor-e*, *mbiprodhim*, *marr në kujdes a kujdestari*.

Një ndryshim tjetër cilësor në leksikun politiko-shoqëror, si rezultat i ndryshimeve revolucionare në jetën e strukturën e vendit tonë është edhe nxjerrja jashtë përdorimit aktiv të elementeve që shënonin fenomene feudalo-kapitaliste të çfrytëzimit ose të mënyrës së vjetër të jetesës si p.sh. kalimi në historizma të termave *bej*, *aga*, *çiflig*, *çifligar*, *argat*, *prefekt*, *prefekturë*, *kryeplak*, *kryepleqësi-a*, *e dhjetë-a*, *dhjetar-i*, *mbret*, *mbretëshë*, *princ*, *princeshë*, *shkëlqesi*, *zot-i a zotni*, *zonjë*, *xhandar*, *mëlic*, *kapitalist*, *borgjezi-a*, *kuesturë*, *luogotenencë*, *bersalier*, *pronë private* etj. Kalimi i këtyre fjalëve në historizma nuk do të thotë largim i tyre nga gjuha. Disa prej tyre si *bej*, *aga*, *çiflig*, *çifligar*, *argat*, *qehaja* etj. do të vazhdojnë të përdoren në gjuhën e shkrimit e të folurit, në tekste të historisë ose në letërsinë artistike sa herë bëhet fjalë për marrëdhënjet e çfrytëzimit e të nënshtrimit të popullit tonë në rregjimet e kaluara. Kurse fjalët *mbret*, *mbretëshë*, *princ*, *kapitalist*, *borgjezi-a*, *shkëlqesi*, *matrapaz*, *pronë private* etj. do të përdoren ende kur të bëhet fjalë edhe për të sotmen e vendeve të huaja, sistemi shoqëror i të cilave s'ka asgjë të përbashkët me sistemin tonë, me ideologjinë tonë.

III. Të gjitha këto ndryshime cilësore brendapërbrenda leksikut politiko-shoqëror të shqipës kanë sjellë një pasurim të madh të tij në sasi. Ky pasurim do të thotë rritje, në një masë të madhe e më shpejt, të elementeve të reja të domosdoshme të këtij leksiku, në raport me zhdukjen, në një masë më të vogël e më ngadalë të elementeve të vjetra e të panevojshme.

Pse pikërisht në këtë etapë të zhvillimit, leksiku politiko-shoqëror pësoi gjithë këto ndryshime cilësore e sasiore? Arësyet e këtyre ndryshimeve do t'i kërkojmë në faktorët jashtëgjuhësorë dhe gjuhësorë. Faktorët jashtëgjuhësorë kanë luajtur rolin kryesor në ndryshimet që ka pësuar ky leksik pas çlirimit, sepse ai është i lidhur më ngushtë me

8) Shih edhe A. Kostallari, *Parimet...*, f. 52,

ndryshimet e mëdha në jetën tonë politiko-shoqërore që ndodhën fill pas krijimit të PKSH (sot PPSH.) e deri në ditët tona. Sa më të thella ishin ndryshimet në jetën shoqërore aq më të mëdha u bënë edhe ndryshimet në këtë fushë të leksikut. Revolucioni ynë popullor përmbysi jo vetëm bazën e vjetër, por edhe superstrukturën e saj, në vend të së cilës lindi një superstrukturë e re, ku u zhvilluan procese e fenomene të reja, të cilat kishin nevojë për t'u emërtuar me fjalë të reja. Zhvillimi i leksikut politiko-shoqëror mori hov veçanërisht pas çlirimit me «krijimin e njeriut të ri të pajisur me ndërgjegje të lartë socialiste dhe veti të shquara revolucionare»<sup>9</sup> me botëkuptim, pikëpamje e koncepte të reja, që merr pjesë aktive në zgjidhjen e detyrave me rëndësi shtetërore dhe që në krye të gjithë veprimtarisë së tij vë politikën e Partisë. Sot politika, si element (kategori) i superstrukturës jo vetëm i shërben më fort se anët e tjera bazës, por edhe po rrit gjithnjë e më shumë ndikimin mbi anët e tjera të superstrukturës. Shumë probleme që dikur para çlirimit konsideroheshin si jashtë politikës ose problemeve shoqërore, në kohën tonë u futën brenda problemeve politiko-shoqërore. Rrethi që mbështjell problemet e ndryshme shoqërore po zgjerohet gjithnjë e më shumë. Kjo gjë ka sjellë edhe një zgjerim të fushës së kësaj terminologjie, një përhapje më të madhe të leksikut politiko-shoqëror në popull, si edhe një shtrirje më të gjërë të tij në sistemin leksikor të shqipes.

Përhapja e përvetësimi i leksikut politiko-shoqëror pas çlirimit nga masat e gjëra është një element i ri cilësor i tij, që e dallon nga ai i paraçlirimit. Edhe para çlirimit ka pasur një terminologji politiko-shoqërore, por të kufizuar në përhapje. Përvetësimi i këtij leksiku nga masat popullore ka pasur kryesisht karakter spontan e të pandërgjegjshëm<sup>10</sup>, meqenëse edhe politika në të kaluarën nuk u shërbente masave, por interesave të klasave çfrytëzuese.

Dalja nga shtypi pas çlirimit e një literature të shumtë politiko-shoqërore, krijimi i Institutit të marksizëm-leninizmit dhe i shkollës së Partisë, përkthimi i veprave të klasikëve të marksizëm-leninizmit, botimi tani së fundi i veprave të shokut Enver dhe i Historisë së PPSH, mbizotërimi i filozofisë marksiste-leniniste si e vetmja filozofi revolucionare në jetën tonë politike e shoqërore, përvetësimi nga ana teorike dhe zbatimi i saj në jetën praktike nga masat, sollën jo vetëm një pasuri të madhe të leksikut politiko-shoqëror, por edhe një përhapje të gjërë të tij në masat e popullit. Këtë e vërteton, nga ana gjuhësore, edhe rritja e zgjerimi i lidhjeve semantiko-sintaktike të termave politiko-shoqërore me fjalë të tjera të shqipes. Për këtë le t'u hedhim një sy lidhjeve të sotme semantiko-sintaktike të termave *politik-e* dhe *politikë-a* me fjalë të tjera dhe do të vemë re se ato janë rritur shumë në krahasim me ato të paraçlirimit. Sot gjejmë në shqipen e shkruar ose të folur: *aksion politik, bashkëpunim politik, bindje politike, bisedime politike, byro politike, çështje e problem politik, çlirim politik, dështim politik, diferencim politik, ekonomi politike, fitore politike, fjalor politik, formë politike, fushë politike, gjendja a situatë politike, hartë politike, jetë politike, kalitje politike, e kaluara politike, karak-*

9) E. Hoxha, *25 vjet luftë e fitore në rrugën e socializmit*. (Zëri i popullit, 29 nëntor 1969, f. 2).

10) Kemi parasysh më shumë periudhën para fillimit të lëvizjes komuniste në Shqipëri.

ter politik, kërkesë politike, komisar politik, konsolidim politik, kontradikta politike, kriminel politik, krizë politike, kufomë politike, largpamësi politike, letërsi politike, luftë politike, marrëdhënje politike, marrëveshje politike, mashtrim politik, me syrin politik, mjet politik, ndërjegjeje politike, ndjek një politikë, nga ana politike, ngritje politike, nivel politik, orë politike, organizatë politike, paqartësi politike, parullë politike, pasojë politike, pavarësi politike, përmbajtje politike, pikëpamje politike, pjekuri politike, politikë revolucionare, politikë shtypjeje e terrori, politikë e drejtë, politikë antipopullore, politikë hegjemoniste, politikë e jashtme, politikë e brendshme, politikë proletare, politikë me dy faqe, politikë e kuadrit, politikë e kanonierave, politikë e miqësisë dhe e bashkëpunimit, program politik, punë politike, pushtet politik, qartësi politike, qëndrim politik, rëndësi politike, rregjim politik, sekretar politik, seminar politik, sferë politike, sundim politik, shkollë politike, shtypje politike, terror politik, ndhëheqës politik, vështrim politik, zgjidhje politike etj. Një shtrirje pothuajë kaq të gjerë lidhesh kanë edhe termat *klasë-a* e *klasor-e*, *Parti-a*, *kontradiktë-a*, *popullor-e* e *revolucionar-e*.

Këto veçori e bëjnë leksikun politiko-shoqëror të pasqirimit të zërë një vend të mirë në mbarë leksikun terminologjik të shqipes; fusha e leksikut politiko-shoqëror është një nga fushat me terminologji më të pasur në gjuhën tonë dhe më me interes studimi.

Mund të thuhet se zhvillimi që mori leksiku politiko-shoqëror pas çlirimit po e çon atë drejt përsosjes; këtë zhvillim dhe përsosje e ka ndihmuar dhe po e ndihmon zhvillimi që kanë marrë shkencat politiko-shoqërore pas çlirimit në vendin tonë si edhe studimet e ndryshme me karakter terminologjik. Por akoma nuk mund të thuhet se është krijuar përfundimisht një terminologji politiko-shoqërore me kufij pak a shumë të prerë. Ky kufi i prerë nuk mund të vendoset tani sepse terminologjia politiko-shoqërore është ende në zhvillim; tipar i saj i sotëm është se ajo vazhdon jo vetëm të pasurohet me elemente të leksikut të përgjithshëm por edhe terma të leksikut politiko-shoqëror po bëhen pjesë përbërëse të leksikut të përgjithshëm. Ata po hyjnë e përdoren jo vetëm në tekste shkollore por edhe në letërsinë artistike. Madje disa fjalë të kësaj terminologjie kanë hyrë ose po hyjnë edhe në fondin më aktiv e më të përgjithshëm të leksikut (*parti-a*, *komunist-i*, *partizan-i*, *organizatë*, *kryetar*, *mbledhje*, *revolucion*, *revolucionar-e*, *kooperativë*, *anëtar partie*, *këshill popullor* etj.)

Për arsye të përhapjes e të përdorimit të gjërë të leksikut politiko-shoqëror në gjuhën e shkruar e të folur, të marrëdhënjeve të ngushta të tij me leksikun e përgjithshëm, ai ndikon mjaft edhe në formimin e gjuhës së sotme letrare dhe kristalizimin e normës së saj. Ky ndikim do të jetë më i efektshëm kur të vendoset përfundimisht edhe një normë terminologjike në këtë fushë të leksikut. Por kjo nuk është vendosur akoma përderisa vazhdojmë të përdorim edhe sot dy terma me të njejtin kuptim terminologjik si p.sh. *koncept* e *nocion* *pakt-i* e *traktat-i*<sup>4</sup>, *steitizëm* (BFM. f. 407) e *etatizëm* (PPSH. kundër bur.), *fushë* e *lëmë* (ndërkombëtar), *domosdoshmëri* e *domosdo-ja*, *ndërkombëtar-e* e *ndërbotëror-e* (Kap. f. 115), *largpamës*, *tejpamës* (PPSh. udh. e rev. f. 40) e *tejshikues* (PPSh. udh. e rev. f. 29), *largpamësi-a* e *tejpamësi-a* (PPSh. udh. e rev. f. 104), *ligjësoj* e *ligjëroj*, *ligjësi-a* e *ligjëshmëri*, *pashmangësi-a* (BFM. f. 467) e *pashmangëshmëri*,

*vazhdimësi* (BFM. f. 116) e *vazhdueshmëri* etj. Në këto raste si kriter norme do të shërbejnë këta faktorë: përdorimi e përhapja më e gjerë, ngulitja në gjuhë, formimi në bazë të mënyrave e tipeve më prodhuese të shqipes, përputhja e rregullt e strukturës fjalëformuese me strukturën semantike si edhe karakteri ndërkombëtar më i dukshëm, më i theksuar, më pak relativ për termat me burim të huaj. Sipas këtyre kritereve del se termat *fushë*, *domosdoshmëri*, *ndërkombëtar-e*, *larg-pamës*, *largpamësi*, *ligjëroj*, *ligjëshmëri*, *pashmangshmëri*, *vazhdueshmëri*<sup>11</sup>, fitojnë sipërinë mbi të tjerat.

Norma terminologjike e leksikut politiko-shoqëror, ashtu si edhe ajo e fushave të tjera, nuk mund të vendoset pa vendosjen në mënyrë të plotë e përfundimtare të normës në gjuhën letrare. Sukseset e arritura pas çlirimit në kristalizimin përfundimtar të normës së gjuhës sonë letrare<sup>12</sup> natyrisht do të ndikojnë edhe në vendosjen e normës terminologjike në këtë fushë të leksikut. Botimi në të ardhmen i një fjalori politiko-shoqëror do të ndihmonte në njësimin e kësaj terminologjie; ai do të konsakronte edhe rezultatet e arritura nga studimet mbi këtë fushë të leksikut.

### Shkurtimet

H.PPSH = Historia e Partisë së Punës së Shqipërisë, Tiranë, 1969.

EH.1 = Enver Hoxha, Veprat, I, Tiranë, 1968

BFM = Bazat e filozofisë marksiste, Tiranë, 1960

PPSH. kundër bur. = PPSH. për luftën kundër burokratizmit, për një stil. revolucionar në punë. Tiranë 1968.

PPSH. Mbi centr. dem. = PPSH mbi centralizmin demokratik në parti - Tiranë 1968.

PPSH. udh. e rev. = PPSH udhëheqëse e revolucionit dhe e ndërtimit socialist, Tiranë 1968.

Bashk. = gaz. Bashkimi.

ZP = gaz. Zeri i popullit.

EK. pop. = Ekonomia popullore (rev.)

Dr. = gazeta «Drita»

Len. XXI. = V.I.Lenin. Veprat. XXI. Tiranë 1965.

Kap. = K.Marks, Kapitali. Tiranë 1968.

P. agimit = Sh. Musaraj, Para agimit, Tiranë.

J.Malo... Bota arabe = J.Malo - F.Paçrami, Bota arabe është zgjuar. Tiranë 1958.

11) Këshillojmë përdorimin e fjalë-termave që janë emra abstraktë më -(ë)ri të formuar nga mbienrat më -shëm për arsye se kjo strukturë fjalëformuese në krahasim me formimet më -(ë)si, pajtohet sot më shumë me prirjen drejt një prodhueshmërie të madhe që ka marrë ky tip formimi në mbarë shqipen. Por, duhet thënë, gjithashtu, se edhe formimet më -(ë)si kanë prodhueshmëri të madhe në shqipen e sotme.

12) Shih A. Kostallari, *Mbi tiparet kryesore të shqipes së sotme letrare*, «Shkenca shoqërore në shkollë», Tiranë, 1967.

## Résumé

LE LEXIQUE POLITICO-SOCIAL DE L'ALBANAIS  
ET SON DEVELOPPEMENT APRES LA LIBERATION

Dans l'article ci-contre l'auteur expose quelques-unes des particularités du développement du lexique politico-social durant les 25 années de la libération du pays. Ces particularités vont rattachées aux facteurs politico-sociaux qui ont influé après la libération sur le développement de ce lexique.

Après avoir brossé quelques traits du lexique politico-social, les termes qu'il embrasse, les rapports de ces termes avec le lexique général, l'auteur s'arrête aux différences qualitatives et quantitatives qu'a subies le lexique politico-social en les envisageant sur le plan sémantique et sur celui de la formation des mots.

La nouvelle attitude politico-sociale des hommes envers les objets, les phénomènes ou les concepts après la libération est reflétée dans ce lexique par des modifications dans l'acception des mots et des termes de ce domaine. Ainsi, p. ex., certains mots comme *hop-i* «bond», *ko-hë-a* «temps», *zë-ri* «la voix», *huaj* (i, e) «étranger, ère», etc. ont acquis de nouveaux sens et ont été élevés en termes. D'autres, comme *shër-bëtor* «servant», *zotëri* «monsieur», *car* «tzar», *xhandar* «gerdarne», etc., ont pris de nouvelles nuances sémantiques et stylistiques.

Sur le plan de la formation des mots, la particularité fondamentale du développement de ce lexique est la grande productivité des termes formés synthétiquement en utilisant plutôt le mode affixal et la composition.

Le domaine du lexique politico-social est un des domaines qui a la terminologie la plus riche dans notre langue et du plus grand intérêt pour l'étude.